

JEHONA e VJOSËS

Festivali Folklorik Mbarëkombëtar

Mirë se vini në
FESTIVALIN FOLKLORIK MBARËKOMBËTAR
"JEHONA E VJOSËS" Edicioni III
Memaliaj | 26 - 27 Qershor 2026



Festivali Folklorik Mbarëkombëtar

“JEHONA E VJOSËS”

– EDICIONI III

Ky eveniment i madh kulturor dhe artistik, i cili zhvillohet për herë të tretë, organizohet nga **Shoqata “AlbAccess Open”**, me mbështetjen e **Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit** dhe **Bashkisë Memaliaj**.

Festivali Folklorik Mbarëkombëtar **“Jehona e Vjosës”** vjen për herë të tretë si një ngjarje e rëndësishme artistike dhe kulturore, kushtuar trashëgimisë shpirtërore, traditës polifonike, kulturës, brezave dhe promovimit të turizmit në zonë.

Ky festival tashmë është kthyer në një traditë dhe domosdoshmëri artistike për komunitetin e Memaliajt dhe më gjerë, duke sjellë në skenë vlerat autentike të folklorit shqiptar.

Mbi **300 artistë** nga të gjitha trevat shqiptare, diaspora, nga veriu në jug do të bëhen pjesë e këtij festivali.

Pjesëmarrja e grupeve polifonike, ansambleve dhe artistëve do të nxisë shkëmbimin e përvojave artistike, ruajtjen e melodive tradicionale, promovimin e krijimeve të reja dhe pasurimin e jetës kulturore. Përgjatë dy netëve artistike, publiku do të përjetojë emocione të veçanta, traditë, folklor dhe interpretime mbresëlënëse.

Një nga qëllimet kryesore të festivalit është përcjellja te brezat e rinj e dashurisë për folklorin, kulturën dhe ruajtjen e traditave tona më të mira kombëtare.

Risia dhe vlera më e madhe e këtij festivali mbetet ruajtja e pastërtisë artistike dhe e vlerave burimore të folklorit shqiptar, si pjesë e identitetit kulturor të popullit tonë.

Mirë u takofshim në edicionet e ardhshme të “Jehonës së Vjosës”!



PROGRAMI I DATAVE 26–27 QERSHOR 2026

18:00 – 19:00 | Ceremonia e Hapjes dhe Kokteji i Mirëseardhjes

Sheshi “Minatori”, Memaliaj

- Mikëpritja e grupeve pjesëmarrëse dhe të ftuarve specialë.
- Koktej mirëseardhjeje.
- Prezantimi i ekspozitës me piktura dhe fotografi nga dy edicionet e mëparshme të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar “Jehona e Vjosës”.

19:00 | Parada e Grupeve Pjesëmarrëse

- Prezantimi i grupeve folklorike, ansambleve artistike dhe artistëve pjesëmarrës në festival.

19:30 | Ceremonia Zyrtare e Hapjes së Festivalit

- Hapja zyrtare e Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar “Jehona e Vjosës” – Edicioni III.

Memaliaj, 26–27 Qershor 2026

Dy netë folklor, traditë, kulturë dhe emocione në zemër të Luginës së Vjosës.

PROGRAMI 26 QERSHOR 2026

- Përshëndetja e Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, z. Albert Malaaj.
- Përshëndetje nga vajzat e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, Bashkia Memaliaj (koreograf: Arben Haxhia).
- Përshëndetje nga Ansambli “Dardania” – Tropojë.
- Kërcimi i Tropojës, i shoqëruar me bilbil dhe tupan, interpretuar nga grupi i valleve “Dardania” – Tropojë (koreograf: Shpresart Memia).

- Nr. 1 – **Ansambli i Përmetit**
Nr. 2 – **Grupi Polifonik “Djemtë e Vlorës”** (Vasil Sera) – Vlorë
Nr. 3 – **“Tre Tinguj, Një Melodi”** – Malësi e Madhe
Nr. 4 – **Grupi Polifonik “Epiriotët”** – Tepelenë
Nr. 5 – **Aktori Myzafer Abedi** – Memaliaj (Përshëndetës)
Nr. 6 – **Ansambli “Shebeniku”** – Librazhd
Nr. 7 – **Grupi Polifonik “Çajupi”** – Zagori, Gjirokastrë
Nr. 8 – **Ansambli Artistik “Kaltrësia”** – Kamëz
Nr. 9 – **Grupi Polifonik Memaliaj**
Nr. 10 – **“Rapsodët e Klinës”** – Klinë, Kosovë (Përshëndetës)
Nr. 11 – **Grupi Polifonik “Gjergj Araniti”** – Mallakastër
Nr. 12 – **Grupi Polifonik Kolonja** – Gjirokastrë
Nr. 13 – **Grupi Polifonik i Qytetit Tepelenë** (Përshëndetës)
Nr. 14 – **Sazet e Kolonjës** – Kolonjë

PROGRAMI 27 QERSHOR 2026

- Përshëndetja e Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, z. Albert Malaaj.
- Përshëndetja e Drejtorit Artistik të Festivalit “Jehona e Vjosës”, z. Viktor Aliu.

- Nr. 1 – **Ansambli Folklorik “Bejkë e Bardhë”** – Pllur, Himarë
Nr. 2 – **AKV “Trojet Tona”** – Ulqin, Mali i Zi
Nr. 3 – **Grupi Polifonik “Djemtë e Bogonicës”** – Vlorë
Nr. 4 – **Fyelltarët e Gramshit** – Gramsh
Nr. 5 – **Grupi Polifonik “Malli i Mërgimtarit”** – Diaspora Shqiptare, Patra (Greqi)
Nr. 6 – **Rapsodët e Deçanit** – Deçan, Kosovë (Përshëndetës)
Nr. 7 – **Ansambli Folklorik “Thesaret Labe”** – Tiranë
Nr. 8 – **Ansambli “Dardania”** – Tropojë
Nr. 9 – **Grupi Polifonik “Kaonët”** – Delvinë
Nr. 10 – **Linda Aliaj** – Memaliaj (Përshëndetëse)
(Reciton baladën për emigrantët nga autori Pëllumb Aliaj.)
Nr. 11 – **Grupi Polifonik “Rroms”** – Selenicë
Nr. 12 – **AKV “Shote Galica”** – Drenas, Kosovë
Nr. 13 – **Denis Mirani dhe Mariana Gjika** – këngëtarë (Përshëndetës)

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE

Falenderojmë Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për mbështetjen dhe financimin e këtij Festivali Folklorik Mbarëkombëtar.

Falenderojmë Bashkinë Memaliaj dhe Këshillin Bashkiak, në mënyrë të veçantë Kryetarin e Bashkisë, Z. Albert Malaj, për partneritetin, mbështetjen dhe gatishmërinë e treguar për realizimin e këtij evenimenti mbarëkombëtar në qytetin e Memaliajt.

Falenderojmë Këshillin e Qarkut Gjirokastrë dhe, në mënyrë të veçantë, Kryetarin Z. Dino Selimi, për mbështetjen dhe financimin e këtij Festivali Folklorik Mbarëkombëtar.

Falenderojmë Shoqatën Kulturore, Atdhetare dhe Patriotike "Tafil Buzi" për mbështetjen dhe kontributin e dhënë në realizimin e këtij festivali.

Shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për të gjithë donatorët, bizneset, miqtë dhe dashamirësit që kanë kontribuar dhe na kanë mbështetur në organizimin dhe realizimin me sukses të këtij festivali.

Falënderojmë grupet folklorike, ansamblet artistike dhe të gjithë artistët pjesëmarrës, të cilët me talentin dhe përkushtimin e tyre do të ngjiten në skenën e festivalit si garues dhe përshëndetës.

Në mënyrë të përzemërt dhe me respekt, falenderojmë qytetarët e Memaliajt, të ftuarit. Miqtë dhe publikun e gjerë që do të ndjekin dhe mbështesin këto dy netë festive, duke u bërë pjesë e atmosferës së bukur të folklorit dhe traditës shqiptare.

ORGANIZATORËT E FESTIVALIT

Drejtor Artistik i Festivalit: **Viktor Aliu**

Hartues dhe Menaxher i Projektit të Festivalit: **Enkeleida Z. Fejzo**

Partner Kryesor: **Bashkia Memaliaj**

Moderatorët e Festivalit: **Migena Kraja** dhe **Ermir Hoxha**

Partner Mediatik: **TV Apollon**

Organizator i Projektit: **Shoqata "AlbAccess Open"**



✉ festivaljehonaevjoses@gmail.com ☎ 069 47 51 205

